



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.201/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “N...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati Q.Z nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., -Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi nga baza e sigurimit të pronës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.266/18 i datës 30/09/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10/02/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET** pika I e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.266/18 i datës 30/09/2020 dhe gjykohet si vijon: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses “N...” sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të demit sipas rastit të siguruar me polisen e sigurimit nr...., t’ia paguaj paditëses shumen prej 11,605.35 euro, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II.REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses “N...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të demit sipas rasteve të siguruar me polisën e sigurimit nr...., t’ia paguaj paditëses shumen prej 38,064.05 euro, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

III.REFUZOHET pjesa tjetër e ankesës së të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** pika II e

dispozitivitet të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.266/18 i datës 30/09/2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.266/18 i datës 30/09/2020, ka vendosur si në vijim:

I. Miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses "N..." sh.p.k., me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." sh.a., - Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet pala e paditur që në emër të katër rasteve të siguruara me policat e sigurimit ... dhe ..., palës paditëse t'ia kompensoj dëmin në shumën e përgjithshme prej 49,669.40 €, me normë të kamatës prej 8 % në vit, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë dt.08.05.2018, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II.Detyrohet pala e paditur që palës paditëse t'ia paguaj shumën prej 1,850.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që paditëses t'ia gjykoj shumën prej 11,605.35 euro për rastin sipas policës së sigurimit ...0, me interes nga data e marrjes së aktgjykimit, ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadisë për tri raste tjera sipas policës së sigurimit ..., në vlerën prej 38,064.05 euro, të refuzohet kërkesëpadia si e pa bazuar ose aktgjykimi në pjesën e atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim e rivendosje.

Pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka kërkuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 pika e) e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja “N...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 08/05/2018, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., - Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se e paditura i ka lëshuar paditëses polisën e sigurimit të pronës me numër ...0, me të cilën janë siguruar mallrat e paditëses deri në shumën 3,500,000.00 euro për periudhën kohore nga data 30/12/2015 e deri me datën 29/12/2016, më tutje theksohet se me datën 19/12/2016 ka ndodhur vjedhja në objektin e paditëses në Gjilan, ku janë vjedhur 7 telefona mobil, 7 tabletë dhe 20 laptop e që sipas ekspertizës financiare ka rezultuar se vlera e mallit të vjedhur në lokalin e paditëses është në shumë prej 11,605.36 euro e cila vlerë nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse si dhe nuk ishte kontestuese se dëmi ishte i mbuluar me polisen e sigurimit nr..... Mandej palët ndërgjyqëse kanë lidhur edhe polisën tjetër të sigurimit të pronës me numër ..., me të cilën janë siguruar mallrat e paditëses deri në shumën prej 3,674,000.00 euro për periudhën kohore 30/12/2016 deri me datën 29/12/2017, ashtu që me datën 10/04/2017 ka ndodhur vjedhja në objektin e palës paditëse në Gjilan, ku janë vjedhur 8 laptop, 10 telefona mobil dhe 8 tabletë në vlerë prej 8,209.28 euro, pastaj me datën 13/01/2017 ka ndodhur vjedhja në objektin e palës paditëse në Fushë Kosovë, ku janë vjedhur sende në vlerë prej 14,583.04 euro si dhe me datën 23/02/2017 ka ndodhur vjedhja në objektin e paditëses në Ferizaj, për pasoj palës paditëse i janë vjedhur mallra në vlerë prej 15,271.72 euro apo shuma e përgjithshme e demit e vlerësuar me ekspertizë financiare arrin shumen prej 49,669.40 euro.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit me tej thekson se është fakt se me nenin 4 pika 3 të Kushteve të Përgjithshëm të Sigurimit të bashkangjitura Polises së Sigurimit me numër ... është përcaktuar se nuk do të mbulohen me policë të sigurimit pajisjet elektrike (të lëvizshme) siç janë: telefona celular, aparate fotografike, kamera, laptop dhe pajisje të kësaj kategorie ndërsa në kushtet e veçantë të sigurimit të integruar në polisen e sigurimit është specifikuar se sigurohen mallrat sipas listës së njërive të siguruara, nga kjo rezulton se mallrat e vjedhura janë mbuluar me polisen e sigurimit dhe ka kontradikta në mes kushteve të përgjithshme dhe

Polises së Sigurimit dhe në rastin konkret vlen marrëveshja e veçante. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 918-962, nenin 940, dhe nenin 124 par.4, nenin 125 par.1 dhe par.2 dhe nenin 382 par.1 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është në tërësi i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë sa i përket pjesës ndryshuese, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti se rasti i siguruar ka ndodhur me datën 19/12/2016, ku në objektin e paditëses janë vjedhur 7 telefona mobil, 7 tabletë dhe 20 laptop e që sipas ekspertizës financiare ka rezultuar se vlera e mallit të vjedhur në lokalin e paditëses është në shumë prej 11,605.36 euro e cila vlerë nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, e po ashtu nuk ishte kontestuese se dëmi i shkaktuar ishte i mbuluar me polisen e sigurimit nr....0 dhe në bazë të nenit 918 të LMD-së, shprehimisht parashihet: *Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër.* Në rastin konkret nuk ishte kontestuese se paditësja e ka përmbushur obligimin e saj ndaj të paditurës me pagimin e primit, ndërsa e paditura me paraqitjen e rastit të siguruar nuk e ka përmbushur obligimin e

saj si në shumën e gjykuar edhe përkundër asaj si ka paraqitur gatishmëri për kompensimin e demit në lartësi prej 11,605.36 euro, andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara si dhe në nenin 940 të LMD-së është krijuar detyrimi për kompensim dëmi.

Gjykata e Apelit me kujdes të shtuar i ka analizuar pretendimet ankimore në raport me Kushtet e Përgjithshëm të Sigurimit të bashkangjitura Polises së Sigurimit me numër ... dhe gjeti se ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar dhe mbi bazën e kësaj vendosi si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se me ekspertizën financiare është vërtetuar fakti vendimtar se në objektin e paditëses në Gjilan, me datën 10/04/2017 janë vjedhur: 10 smartphone, 8 laptop dhe 18 tableta, në vlerë të përgjithshme prej 8,209.29 euro, pastaj në objektin e paditëse në Fushë Kosovë, me datën 13/01/2017 janë vjedhur: 7 smartphone, 31 laptop, 5 tableta dhe 2 aparat, në vlerë të përgjithshme prej 14,583.06 euro, dhe me datën 23/02/2017 në objektin e paditëse në Ferizaj janë vjedhur: 24 smartphone, 11 laptop dhe 7 tableta, në vlerë të përgjithshme prej 15,202.91 euro e cila e ekspertizë bazohet në raportet policore e që gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk e ka vlerësuar drejt dhe në raport me nenin 4 pika 3 të Kushteve të Përgjithshëm të Sigurimit të bashkangjitura Polises së Sigurimit me numër ... e cila klauzol parasheh: *Nuk do të mbulohen me policë të sigurimit pajisjet elektrike (të lëvizshme) siç janë: telefona celular, aparate fotografike, kamera, laptop dhe pajisje të kësaj kategorie.*

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret nuk qëndrojnë konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se kemi mospërputhje ndërmjet kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta, sepse me kushtet e përgjithshme të sigurimit rregullohen çështjet e përbashkëta për disa lloje të ngjashme të sigurimit, siç janë kushtet e përgjithshme për sigurimin e pasurisë nga vjedhja ndërsa me kushtet e veçanta të sigurimeve rregullohen çështjet specifike lidhur me llojet e caktuara të sigurimeve, siç janë kushtet për sigurimin nga vjedhjet, ku palët ndërgjyqëse në mënyrë decidivie i kanë përjashtuar sigurimin e pajisjeve të caktuara elektrike në rast të vjedhjeve, andaj paditësja në njërin anë, me nënshkrimin e Policës së Sigurimit nr...., ka vërtetuar faktin se është i pajtimit për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe, në anën tjetër, me nënshkrimin e vet vërteton faktin se nga siguruesi i ka pranuar edhe kushtet përkatëse të përgjithshme të cilat i ka nënshkruar në secilën fletë. Sipas nenit 124 par.1 të LMD-së është paraparë: *Kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një palë kontraktuese, qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe si rregull janë njësoj detyruese, ndërsa me nenin 950 par.1 të LMD-së është paraparë: *Siguruesi ka për detyrë t'i shpërblejë dëmet e shkaktuara**

rastësisht ose për faj të kontraktuesit të sigurimit të siguruarit ose të shfrytëzuesit të sigurimit, përveç nëse për dëmin e shkaktuar ky detyrim i tij është përjashtuar shprehimisht me kontratën e sigurimit, andaj gjykata e shkallës së parë në rastin konkret gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale të paraparë me nenin 124.4 dhe nenin 125 të LMD-së, kur ka vendosur si në diapozitivin e aktgjykimit ankimor.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore lidhur me datën e llogaritjes së kamatës dhe vendimit për shpenzimet e procedurës dhe të njëjtat i vlerësoj si të pa bazuara, për arsye se gjykata e shkallës së parë drejt e ka zbatuar nenin 382 të LMD-së, kur paditëses ia ka njohur kamatëvonesën nga data kur paditësja ka kërkuar kompensimin e demit sepse nga kjo datë e paditura ka rënë në vonesë kur nuk e ka mbushur detyrimin brenda afatit deri në pagesën definitive e po ashtu i drejtë del të jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të tij në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 pika e) e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.201/20, me datën 10/02/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku